



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “Salillari” shpk

Adresa: Lagjja Vorë, Rruga e Vjetër, Vore, Marikaj, Km 1, Godina katër katëshe, Kati i tretë, Nr.5

TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: **”Rikonceptim i parkut të lojrave të fëmijëve dhe parkim publik 2 kate nën tokë në rrugën e Elbasanit”**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **”Rikonceptim i parkut të lojrave të fëmijëve dhe parkim publik 2 kate nën tokë në rrugën e Elbasanit”**, duke realizuar Rikonceptimin e parkut të lojrave të fëmijëve dhe ndërtimin e parkimit publik 2 kate nën tokë në rrugën e Elbasanit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit

Fondi limit: **276.503.894** (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH.**

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.84 datë 29.12.2016 për ”Miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr.prot.154/2 datë 17.01.2017.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **datë 01.11.2017 , ora 11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike nr.40 datë 09.10.2017**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “G.P.G COMPANY” shpk me nr. NUIS J64324443V

Vlera e ofertës pa TVSH = **262.129.803** (dyqind e gjashtëdhjetë e dy milion e njëqind e njëzetë e nëntë mijë e tetëqind e tre) **lekë pa TVSH.**

2. Operatori Ekonomik ”Salillari” shpk me nr. NUIS J62903125G

Vlera e ofertës pa TVSH = **276.191.416** (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH.**

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

- **Operatori Ekonomik “G.P.G COMPANY” shpk**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Bashkim Operatorësh Ekonomikë, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *AK në Dokumentat Standarte te Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:*

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Për plotësimin e kriterit për shlyerjen e energjisë elektrike, shoqëria “G.P.G Company” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm në portalin elektronik të APP-së për këtë procedurë prokurimi:

“Vërtetim debie” nr. 2325 prot, datë 21.10.2017, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuarit “G.P.G Company” sh.p.k, ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me Kod BE0F040091162688, BE0E130016107778, BE0F020117153735, BE0F020291157179, BE0E130016112074, BE0E020016162775, BE0E020016162774, BE0E020016162771, BE0E020016162785, BE0E020016162776, BE0E020016163405... rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 15.09.2017, pa përfshirë faturën koherente të muajit Shtator 2017”.

- Refruar Neni 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.
- Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin Shtator 2017.
- Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “G.P.G Company” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “dh” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se “Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

- Në dokumentat standarte të tenderit tek **Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 20** citohet:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9)

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjete) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Fabrikë prodhimi betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	2 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion kapaciteti mbajtës për secilën Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 11(njembdhjete) ton dhe maksimumi 17(shtatembdhjete) ton për secilin kamion	7 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	3 copë	Pronësi ose me qera
Mini eskavator	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Depozitë uji (5000)	1 copë	Pronësi ose me qera
Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rretë mbrojtëse për punime në fasadë)	1500 m2	Pronësi ose me qera
Autobot uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Sonde per shpim pilotash	2copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine kapaciteti mbajtës për secilën Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçine	4 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 60 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Kulle ndricimi – 1 cope
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te

shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Per fabriken e prodhimit te betonit, ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqitet akti i pronesise i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1B. Ne rast se operatori ekonomik ka kontrate qeraje duhet te paraqitet akti i pronesise se qiradhensit shoqeruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1B. Kontrata e qerese duhet te jete e noterizuar, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj të jetë i vlefshëm per periudhen e zbatimit te kontrates objekt prokurimi.

Për fabrikën e betonit ,operatori ekonomik duhet te jete i certifikuar me ISO ne prodhim Betoni si me poshte:

- ISO 9001:2008
 - ISO 14001:2004
 - OHSAS 18001:2007
 - PAS 99:2012
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
 - f) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
 - g) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).
 - h) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 26.10.2017 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni nje shkrese prane Drejtorise se Prokurimit Bashkia Tiranë.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjete) ton për secilin kamion si dhe katër Kamionçine kapaciteti mbajtës për secilën Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamion për ekzekutimin e kontratës

Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur në shtojcën 9 në sistemin elektronik të app-së mjetet si më poshtë cituar

- Kamion vetëshkarkues me targa AA514OP F me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **16.4 Ton**
- Kamion me targa AA510EB me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **17.5 Ton**
- Kamion Vetshkarkues LU0783C me targa me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **12Ton**

- Kamion Vetshkarkues LU1167C me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **15.9 Ton**
- Kamion Vetshkarkues AA392KV me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **16.2 Ton**
- Kamion Vetshkarkues AA691GS me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **16.1 Ton**
- Kamion terheqes AA963CV së bashku me gjysëm rimorkion me targa ABR097 me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **37 Ton**
- Kamion terheqes AA763DR së bashku me gjysëm rimorkion me targa ACR886 me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **64 Ton**
- Kamion Vetshkarkues AA326OY me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **16.6 Ton**
- Kamion Vetshkarkues AA213HO me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **13.2 Ton**
- Kamion Vetshkarkues AA513EB me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **16.2 Ton**
- Kamion Vetshkarkues AA486BJ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **17.6 Ton**
- Kamion Vetshkarkues AA514EB me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **18.2 Ton**
- Kamion Vetshkarkues AA512OP me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **12.4 Ton**
- Auto vinç te cilin mund ta konsiderojme dhe si kamion vetshkarkues AA685DN me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **7.8 Ton**
- Kamionçine AA983GF me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.3 Ton**
- Kamionçine AA489LE me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.5 Ton**
- Kamionçine AA854OJ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **3.3 Ton**
- Kamionçine AA712OP me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **0.5 Ton**
- Kamionçine AA433SC me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1 Ton**

Nga sa më sipër rezulton se Operator Ekonomik ka paraqitur në mënyrë të rregullt përsa I përket kapacitetit mbajtës për kamionat vetshkarkues me kapacitet mbajtës nga 5 ton deri 10 ton secili kamion **vetëm një kamion** dhe përkatësisht Auto Vinçin me **targë AA685DN** si dhe ka paraqitur në mënyrë të rregullt përsa I përket Kamionçine kapaciteti mbajtës për secilin Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë **vetëm një kamionçinë nga katër të kërkuara nga AK, Bashkia Tiranë** dhe përkatësisht kamionçina me **targë AA489LE**. Kamionat e mësipërme të deklaruar si dhe kamionçinat e mësipërme operatori ekonomik kanë kapacitetin mbajtës mbi **10 ton** për kamionat dhe poshte **1.5 ton dhe mbi 2 ton** për kamionçinat për këtë fakt nuk do të konsiderohen të rregullta .

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, me pikën 20 përsa u përket kamionave me kapacitet mbajtës **5 ton -10 ton**, kamionçinave me kapacitet mbajtës **1.5 ton -2 ton** secila është i paplotë , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Është kualifikuar si ofertë e suksesshme, Operatori Ekonomik ”Salillari” shpk

- **Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik ”Salillari” shpk kualifikohet në vend të parë.**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **276.191.416** (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë) **lekë.**

Çmimi total i ofertës me tvsh = **331.429.699** (treqind e tridhjetë e një milion e katërqind e njëzetë e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) **lekë.**

Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 24 (**njezetë e katër**) muajve kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 07.11.2017

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori Ekonomik “**G.P.G COMPANY**” shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 41259 Prot. datë 10.11.2017 (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt:

”Rikonceptim i parkut të lojtrave të fëmijëve dhe parkim publik 2 kate nën tokë në rrugën e Elbasanit”

Me marrjen e ankesës nga Operatori Ekonomik i mësipërm, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me Urdhërin me Nr. 41259/1 Prot. dt. 10.11.2017, është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me Urdhërin me Nr. 41259/2 Prot. datë 10.11.2017 u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi ka shqyrtuar ankesën e Operatorit Ekonomik, “**G.P.G COMPANY**” shpk , ka konkluduar sa më poshtë:

Nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura nga Operatori Ekonomik i mësipërm dhe është konsideruar i drejte dhe i bazuar në ligj, Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Ky konkluzion i është rekomanduar Titullarit të Autoritetit Kontraktor si dhe është vënë në dijeni Operatori Ekonomik “**G.P.G COMPANY**” shpk, me anë të shkresës Nr. 41259/4 datë 13.11.2017. (administruar në dosjen e prokurimit).

Më datë 24.11.2017 me anë të shkresës nr. 41259/5 është hequr pezullimi i Urdhërit pasi janë respektuar afatet e ankimit pranë KPP-së.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **Operatori Ekonomik "Salillari" shpk, me adresë:** Adresa: Lagjja Vore, Rruga e Vjetër, Vore, Marikaj, Km 1, Godina katër katëshe, Kati i tretë, Nr.5,Tiranë se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH **276.191.416** (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë), **është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja "Dëshmorët e Kombit", nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

